

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitit 1991

Lënda Nr. IT-04-84-R77.4

Data: 20 maj 2008

Origjinali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE I

Para: Gjykatësit Bakone Justice Moloto, Gjykatës Paragjyqësor

Sekretari: Z. Hans Holthuis

Urdhëresë e datës: 20 maj 2008

PROKURORI

kundër

ASTRIT HARAÇISË

dhe

BAJRUSH MORINËS

PUBLIK

**URDHËRESE PËR PËRCAKTIMIN E DATËS SË NISJES SË PROCESIT
GJYQËSOR**

Zyrës së Prokurorit:

Z. Serge Brammertz

Z. David Re

Z. Stefan Wäspi

Avokatëve të të Akuzuarve

Z. Karim A.A. Khan për Astrit Haraçinë

Z. Jens Dieckman për Bajrush Morinën

Unë, Bakone Justice MOLOTO Gjykatës i përhershëm i Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë prej vitit 1991 (“Tribunali”); pasi jam caktuar gjykatës paragjyqësor bazuar në Rregullën 65^{ter} të Rregullores së Procedurës dhe Provave (“Rregullorja”);¹

DUKE MARRË SHËNIM aktakuzën kundër Astrit Haraçisë dhe Bajrush Morinës, dorëzuar prej Zyrës së Prokurorit (“Prokuroria”) më 8 janar 2008, dhe më pas konfirmuar më 12 shkurt 2008 (“Aktakuza”);²

DUKE MARRË SHËNIM se Aktakuza akuzon

- (1) **Astrit Haraçinë**, për Shpërfillje të Tribunalit (Pika 1) e ndëshkueshme sipas Rregullës 77(A)(iv) të Rregullores ose ndryshe për Nxitje për Shpërfillje të Tribunalit (Pika 2) e ndëshkueshme sipas Rregullës 77(A)(iv) dhe (B) të Rregullores; dhe
- (2) **Bajrush Morinën**, për Shpërfillje të Tribunalit (Pika 1) e ndëshkueshme sipas Rregullës 77(A)(iv) të Rregullores;

DUKE MARRË SHËNIM se Rregulla 77(E) e Rregullores përcakton se Rregullat nga kapitulli 4 deri në kapitullin 8 të Rregullores zbatohen *mutatis mutandis* në çështje të shpërfilljes;

DUKE MARRË SHËNIM se më 29 prill 2008 u zhvillua seanca e parë në prani të Gjykatësit Oric gjatë së cilës të Akuzuarit pranuan se e kishin marrë aktakuzën dhe i kuptonin akuzat e renditura atje;³

DUKE MARRË SHËNIM se gjatë së njëjtës seancë, të Akuzuarit u vetëdeklaruan të pafajshëm;⁴

¹ Urdhëresë për Përbërjen e Trupit Gjykues dhe Caktimin e Gjykatësit Paragjyqësor, 15 shkurt 2008.

² Vendim në lidhje me Shqyrtimin e Aktakuzës, 12 shkurt 2008.

³ IT-04-84-R77.4, Paraqitja e parë, 29 prill 2008 (“Paraqitja e Parë”), T.5.

⁴ Paraqitja e Parë, T. 7-8.

DUKE MARRË SHËNIM se sipas Rregullës 65ter(E) të Rregullores, Gjykatësi Paragjyqësor urdhëron Prokurorinë që jo më vonë se gjashtë javë para Konferencës Paragjyqësore të dorëzojë variantin përfundimtar të Dosjes Paragjyqësore të Prokurorisë, listën e dëshmitarëve që Prokuroria synon t’ ftojë dhe listën e provave materiale që Prokuroria synon të paraqesë;

DUKE MARRË SHËNIM se sipas Rregullës 65ter(F) të Rregullores, Gjykatësi Paragjyqësor urdhëron avokatin e të akuzuarit (“Mbrotjtja”) që jo më vonë se tri javë para Konferencës Paragjyqësore të dorëzojë Dosjen Paragjyqësore;

DUKE MARRË SHËNIM se bazuar në Rregullën 127 të Rregullores, Gjykatësi Paragjyqësor mund të zgjasë ose të shkurtojë çfarëdo afati të përcaktuar në Rregullore, në rast se ka arsye bindëse;

DUKE MARRË PARASYSH se karakteri dhe kompleksiteti i çështjes në fjalë diktojnë një ecuri të shpejtë të dorëzimit të dokumenteve paragjyqësore

BAZUAR në Nenin 20 të Statutit të Tribunalit dhe Rregullat 54, 65ter dhe 127 të Rregullores;

URDHËROJ si më poshtë:

1. Prokuroria të dorëzojë jo më vonë se 2 qershor 2008.

a. një Dosje Paragjyqësore e cila të përmbajë edhe një përmbledhje të provave që Prokuroria synon t’i paraqesë në lidhje me pretendimin për kryerjen e krimit dhe formën e përgjegjësi që bie mbi të akuzuarit. Kjo dosje nuk do të jetë më shumë se 5000 fjalë, dhe përfshin çfarëdo pranimi prej palëve dhe një deklaratë të çështjeve që nuk kundërshtohen si dhe një deklaratë të çështjeve të kundërshtuara faktuale dhe ligjore;

b. listën e dëshmitarëve që Prokuroria synon të ftojë. Kjo listë do të përfshijë emrin ose pseudonimin e çdo dëshmitari, një përmbledhje të fakteve për të cilat do të dëshmojë çdo dëshmitar, numrin e gjithsejtë të dëshmitarëve, informacion nëse dëshmitari do të dëshmojë personalisht apo sipas Rregullave 92bis, 92ter, ose

92*quater*, një parashikim për kohëzgjatjen e nevojshme për çdo dëshmitar dhe kohëzgjatjen e gjithsejtë për procedimin e çështjes prej Prokurorisë;

c. listën e provave materiale që Prokuroria synon të paraqesë;

2. Mbrojtja të dorëzojë jo më vonë se 9 qershor 2008;

a. një Dosje Paragjyqësore me jo më shumë se 5000 fjalë që do të trajtojë çështje faktuale dhe ligjore dhe që përfshin një deklaratë që përcakton në vija të përgjithshme mbrojtjen e të Akuzuarit, pikat në Dosjen Paragjyqësore të Prokurorisë për të cilat i Akuzuari ka kundërshtime dhe në një rast të tillë arsyen e kundërshtimit/eve;

b. listën e dëshmitarëve që Mbrojtja synon të ftojë. Kjo listë të përfshijë emrin ose pseudonimin e çdo dëshmitari një përmbledhje të fakteve për të cilat do të dëshmojë çdo dëshmitar, pikat në Aktakuzë në lidhje me të cilat do të dëshmojë çdo dëshmitar, numrin e gjithsejtë të dëshmitarëve, informacion nëse një dëshmitar do të dëshmojë personalisht apo sipas Rregullave 92*bis*, 92*ter*, ose 92*quater*, një parashikim për kohëzgjatjen e nevojshme për çdo dëshmitar dhe kohëzgjatjen e gjithsejtë për procedimin e çështjes prej Mbrojtjes;

c. listën e provave materiale që Mbrojtja synon të paraqesë.

3. Procesi gjyqësor të zhvillohet më;

- 16 qershor 2008 në 14: 15 - 19:00 në Sallën Gjyqësore 2;
- 17 qershor 2008 në 14: 15 - 19:00 në Sallën Gjyqësore 2;
- 18 qershor 2008 në 14: 15 - 19:00 në Sallën Gjyqësore 2;
- 19 qershor 2008 në 14: 15 - 19:00 në Sallën Gjyqësore 2; dhe
- 20 qershor 2008 në 14: 15 - 19:00 në Sallën Gjyqësore 2;

Përpiluar në anglisht dhe frengjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/ nënshkruar në origjinal/
Gjykatësi Bakone Justice Moloto
Gjykatës Paragjyqësor

Sot, me datën 20 maj 2008
Në Hagë
Holandë

[Vula e Tribunalit]